Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 5.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 2/1;
- c. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 5/1;
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;
- d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;
- dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Dokumentacioni i kërkuar në Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim

2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Operatorit ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilancit të dy viteve të fundit (2018-2019)
- 2.2.2 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate dy viteve te fundit (2018-2019) ku vlera te jete jo më e vogël se vlera e fondit limit qe prokurohet.
- 2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2020.

2.3 Për kapacitetin teknik:

A)

- 2.3.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën ISO 9001:2015 mbi "Sistemet e menaxhimit cilësisë"*
- 2.3.2 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatën ISO 22301: 2012 "Sistemi i Manaxhimit te Vazhdueshmerise se Biznesit".*
- 2.3.3 *OE duhet te disponoje/qera te pakten 1(nje) makineri stampimi dhe qendisje. Per te vertetuar pronesine/qiramarrjen,te paraqitet dokumentacioni i zhdoganimit ose e faturave te blerjes te tyre, ose kontrate qiraje e vlefshme per periudhen e zhvillimit te procedures.*
- 2.3.4 Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij nje inxhinier tekstili. Per te vertetuar kete operatori ekonomik duhet te paraqese Kontraten e punes dhe Diplomen.
- 2.3.5 Operatori ekonomik duhet te deklaroj se merr persiper furnizimin e mallit te kerkuar ne objektin e DST, prane AK Brenda afateve, sasise dhe specifikimet te percaktuara te sasia dhe grafiku i levrimit.
- 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë flete analize nga nje laborator i akredituar ne Republiken e Shqiperise per artikujt *"Xhup dimeror zjarrfikese", "Kostum sherbimi (Intervenimi I lehte flakedurues)" sipas direktives te mbrojtjes nga zjarri*
- 2.3.7 Operatori ekonomik duhet te paraqese mostra ne ditën dhe oren e hapjes se ofertave per artikujt :
"Xhup dimeror , "Kostum sherbimi (Intervenimi I lehte flakedurues)", "Kepuce kambale sherbimi"
Mungesa e mostrës ose mospërputhja e mostrës me specifikimet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor është kusht për skualifikim.
- 2.3.8 Ofertuesi ne rast se nuk eshte prodhues per artikujt e lartepemendur, te paraqese Autorizim nga Prodhuesi, ose distributor i autorizuar, i cili merr persiper te furnizojte Ofertuesin me artikujt objekt prokurimi. Ne rastin e distributorit te autorizuar te paraqitet edhe dokumenti qe verteton lidhjen e distributorit te autorizuar me firmen prodhuese. (Autorizimi te jete i perkthyer dhe i noterizuar, nese nuk eshte ne gjuhen shqipe).

B) Kapaciteti teknik:

Dokumentat Standarde të Tenderit

1. Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit, me një vlerë sa 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

- Kur furnizimi i së njëjtës natyrë është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate.

- Kur furnizimi i së njëjtës natyrë është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore ku të jetë shënuar data, shumat, sasia e mallrave të furnizuara, të nënshkruar nga të dyja palët.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

SPECIFIKIME TEKNIKE (MZSH)

1 Xhupa me shirita fosforeshent

Material sintetik (100% poliamid) kundër shiut dhe erës , cilësi e parë.

Dy shtresa gomimi e dy shtresa akriliku. Pesha $180 \pm 5 \text{gr/ m}^2$.

Veshje të ngrohtë:vatinë $120 \pm 3 \text{gr/ m}^2$.

Astar mëndafshi importi (blu i errët ose i zi) 100 % poliestër , qepur në formë rombi.

Pesha për $\text{m}^2 = 125 \pm 5 \text{ gr}$.

Numuri i fijeve si në bazë e ind(për 10 cm) do të jetë 340 ± 10 fije .

Qëndrueshmëria (kg)në bazë = 95 ± 5 ,ndërsa në ind = 90 ± 5 . Thurje me garniture.

Vlera e qëndrueshmërisë së ngjyrave , nota 4 - 5 .

xhepa poshtë,pllakë me kapak me dy hyrje horizontal dhe vertikal.Mbërthimi para me zinxhir e perçina(me sustë/grifshë).

Qepje industriale me penj blu 80/2; 100% poliestër.

Ngjyra blu e errët. Jaka prerje klasike ngjyre blu e errët. Me kapuç fëshfëshe që mbliidhet prapa jakës

Fashe fosforeshente ,ngjyrë verdhe fosforeshente në shpinë dhe tek rripi i mëngëve nga nje shirit i verdhe fosforeshent 5-6cm gjeresi.

Ne shpine ne fashen e verdhe duhet te jete e qendisur teksti (zjarrfikes) me ngjyre te kuqe floreshente.

Prodhet në përmasat: S; M; L; XL; XXL. XXXL.

2 KOSTUM (XHAKETË + 2 pale PANTALLONA+ KAPELE)

Specifikimi Teknik i artikullit “Kostum ripstop” për sherbimin e MZSH-se paraqet kërkesat themelore teknike të domosdoshme.

Të gjitha përcaktimet teknike të këtij Specifikimi Teknik duhet të zbatohen detyrimisht saktë nga prodhuesi.

Dokumentat Standarde të Tenderit

Materialet që do të përdoren për prodhimin e “Kostumit ” janë:

Lënda e parë: Dok

Përbërja: 65% poliestër 35% pambuk,

Ngjyra: blu navy

Masa: 200 g/m² ± 5

Thurja: ripstop antistatik

Dendësia e fijeve në 10 cm: ne bazë 272 ±10 në ind 254±10

Qendrueshmeria: ne bazë 65.07 N±5% në ind 57.5 N±5%

Numri metric: ne bazë 47.53Nm në ind 41.35 Nm

Trashësia e tekstilit: 0.50mm±0.15mm

Gjeresia e tekstilit: 150cm

Qendrueshmeria ne ferkim : 4200 cikle

Qendrueshmeria e ngjyres: nota 4-5

Qendrueshmeria e ngjyrës duhet të jetë me note 4-5 në gjendje të thatë, njomë, në larje me solucion, me sapun etj

Shkurtimi pas 5 larjesh: 3%

Materiale të tjera që janë përdorur për ndërtimin e kostumit janë:

-Frazelinë (material ngjites për pantallonat) 100% polyester. -Astar për xhepat, material tekstil 100% viskoz.

-Qemer i ngjitur.

-Penj qepje të zinj 80/2 sipas llojit të materialit.

-Qendrueshmeria e tekstilit ndaj flakes: ISO 6941

-Gjatesia e djegies: 40 mm

-Largimi i flakes: 12 sekonda

-Kopsa të vogla të zeza ebaniti që vendosen në anen e djathtë të qemerit, në xhepin mbrapa të pantallonit

-Zinxhir 22-24 cm.

-Kapsa metalike mashkull femër për mbylljen e pantallonave.

PERFORMANCA TË TJERA

Qendrueshmeri antistatike : t₅₀(sek): ≤0,001

Testi I ndezjes elektrostatike: Isol.&tokezim:0%

Qendreshmeri antistatike pas larjes: t₅₀(sek): ≤ 0,01

PËRSHKRIMI

Xhaketa (xhiboksi) është me jakë. Nje xhep ne gjoksin e majte,dhe te djathte te jashtem, qe mberthehet me velkrof dhe kapak, dhe dy xhepa perpara - poshte po me velkrof dhe kapak.

Mberthimi para i xhupit, me zinxhir konfeksioni me dhembe plastike dhe 3

percina/velkrof.

Mëngët në pjesën fundorë të tyre, janë me manshete 5-6 cm me suste/velkrof. Poshte ne te dy krahet kane manshete 10 cm me llastik ne menyre qe siguroje pershtatje me trupin (belin)

- Ngjyra blu navy .

- Prodhoet ne permasat: S; M; L; XL; XXL; XXXL .

- Ne krahun e majte anash, poshte kokes se supit, qepet verkofi femer per vendojen e logos ne krahe

- Ne gjoksin e djathte mbi xhep qepet bazament velkrofi femer per vendosjen e logos se mbiemrit dhe ne gjoksin e majte mbi xhep, qepet verkof femer per vendosjen e logos ne gjoks

Në pjesën e sipërme, në të dyja supet, janë të vendosura spaletat, të cilat fiksohen me kopsa/velkrof.

Ne pjese e kraheve te perimetrit te gjoksit eshte e perbere me shirit fosforeshent 5 cm ngjyre e verdhe fosforeshente zjarr-duruese. OE ne ditën qe do paraqese mostrat duhet te paraqes dhe nje pjese te shiritit fosforishentit antiflake me ngjyre te verdhe 5cm.

Pantallonat janë me të njëjtin material si ai i xhakëtës. Mbërthimi në pjesën e përparme bëhet me kopsa. rripit dhe. Ka dy xhepa të pjerrta para me fileto 3 mm, një xhep prapa me fileto në të cilën ka një vrimë. Në sallki që është me filetë vendoset zinxhiri. Qemri është 4,5 cm i gjerë dhe ka 7 kalime të kthyera dhe pa tegela sipër. Në mes të qemerit në të dy anët vendosen kapse metalike mashkull dhe femër dhe kopsë për mbërthimin në pjesën e sipërme. Në pjesën e brendshme etiketa me shenjat e duhura konvencionale.

Filli që do të përdoret për qepje të jetë të jetë në të njëjtën ngjyrë me copën e kostumit.

Kopsat janë me ngjyrë si tekstili ose e errët. Pantalloni është me astar deri poshte gjurit..

Ne pjesen poshte gjunjeve eshte e perbere me shirit fosforeshent 5 cm.

Kostumi prodhoet në përmasa S, M, L, XL, 2 XL sipas kërkesës së porositësit.

Permasat ne momentin e lidhjes se kontrates

3 Bluza pambuku polo me jake (m/sh dhe m/gj)

Bluze me mende te gjata/shkurtra ,ngjyre blu ,materiali pambuk,,

Pesha: 180 gr/m²

Thurja: Trikotazh

Perberja: 100% pambuk

Çngjyrosja: Nota 4

Bluza te kete velkrof ne anen e majte te gjoksit dhe ne krahun e majte.

Mbrapa ne shpine te kete mbishkrimin zjarrfikes me gri fosforeshente.

4 Kapele doku me stemen e MZSH-se

Material cilesor, blu e erret, me stemen e bashkise ne mes dhe me rrip te prapem per mberthim.

5 Gradat e MZSH-se sipas specifikimeve

Stema, Grada gjoksi, grada spaleti :konform standarteve per uniformat qe perdoren per punonjesit ne sektorin Zjarrfikes.

6) Kepuce uniforme vere

LENDET E PARA E NDIHMESE :

A. Pjesa e siperme.

- Lekure natyrale (boks) viçi, cilesia e pare: sipas (STASH.1143-89)
 - ngjyra e zeze
 - cngjyrosja > nota 4
 - trashesia 1.1 – 1.4 mm
 - yndyra 4 -7 %
 - rezistenca ndaj plasjes se faqes > 1.8 kG/mm²
 - rezistenca ndaj keputjes se faqes > 2.0 kG/mm²
 - zgjatimi ne ngarkese 15 – 25 %
 - qendrueshmeria deri ne keputje 40 – 60 %
 - penetrimi i ujit gjendje statike > 40 minuta
 - rregjia 0 % rregjia shume e mire
- Meshine dhie – cilesia e pare per astarin e faqes, lapetes, mbrapshtines dhe shtrojes me trashesi 0.6 – 1 mm. (STASH -1144-89)
 - yndyra 4 -7 %
 - rezistenca ndaj plasjes se faqes > 1.3 kG/mm²
 - rezistenca ndaj keputjes se faqes > 1.5 kG/mm²
 - zgjatimi ne ngarkese 15 – 30 %
 - rregjia 0 % rregjia shume e mire

- Suprina eshte dy copshe,ne suprine 6cm ne thellesi nga maja, behet bashkimi i dy copave, e cila mbyllet me nje qepje dy tegelesh per zbukurim, kepuca perpara vjen me maje jo shume te theksuar.
- Penje-Sintetike me fortesi 38 kg(4hapa ne 3 cm) per qepjen brenda jashte te fjapes me tabanin,
- penj sintetike me ngjyre te zeze me reziztence mbi 9 kg Nr 40/3 per masuren dhe 30/3 per qepjen e suprines(veshet,mbrapshtines, filetove dhe tegelave te tjere te faqes se kepuces).
- Bombe material termoplastik me trashesi jo me pak se 1 mm.
- Forte material termoplastik me trashesi jo me pak se 1 mm .

B:Pjesa e poshtme.

- Sholle gome kompakte e presuar (pjesa e poshtme e kepuces) me trashesi 5–6 mm nga e cila 1-1.2 mm te jete trashesia e kanaleve ose e luleve(reliev kunder rreshqitjes).
- Taban– Solete (lekure natyrale) me trashesi 2+/-05 mm.
- Fjap gome e presuar me trashesi 3+/-05 mm.
- Xhiro gome e presuar me pjerresi konike e gjeresi 17-19 mm.
- Taka gome e presuar me lartesi 2.8 –3 cm(se bashku me gomen e fjapen qe shoqerohet me xhiro).
- Ngjites 1 komponent per ngjitjen e fjapes me tabanin dhe ngjites 2 komponente per ngjitjen e fjapes me shollen.Ngjitja te jete shume e mire.

Treguesit cilesore te pjeses se poshteme :

- Fortesia ne grade shore per “Shoje te presuar” te jete 73+/-3

Dokumentat Standarde të Tenderit

- Fortesia ne grade shore per “Fiap te presuar” te jete 80+/-5.

Menyra e montimit: Detajet e pjeses se poshtme dhe pjeses se sipërme te kepuces,montohen ne kallep sipas procesit teknologjik,me qepje e ngjitje.

Menyra e lidhjes se kepuces: me lidhese te zakoneshme me gjatesi te pranueshme dhe me 4 (kater) cifte vrimash me syze metalike ne te dyja anet.

8. KAMBALE

KARAKTERISTIKA TE PERGJITHESHME

Kepucet e stervitjes te jene me qafa te gjata dhe ngjyre te zeze.

Lartesia e qafes te jete 23 cm +/- 2 cm

Lartesia e takes 3 cm +/- 0.2 cm (2.4 cm te jete sholle gome e presuar dhe 0.6 cm te jete thellesia e dhembzave ose lules).

Menyra e lidhjes se qafave : te jete me lidhese te zeza me gjatesi 140 cm +/-5 cm, qafa te jene e paisur me syze metalike ne gjithë lartesine e saj dhe lapete ne lartesine e qafes.

Veshet e kapakut te perforcohen me 2 (dy) perçina.

Lidhset te jene sintetike ne forme kordoni, te forta.

LENDET E PARA DHE NDIHMESE

- Lekura te jete lekure natyrale vaqet kundra ujit, cilesia e pare me keto te dhena (sipas STASH 1143 – 89) :

- ngjyra	e zeze
- cngjyrosja	> nota 4
- trashesia	1.6 – 1.9 mm
- yndyra	8 -11 %
- rezistenca ndaj plasjes se faqes	> 1.6 kG/mm ²
- rezistenca ndaj keputjes se faqes	> 2.0 kG/mm ²
- zgjatimi ne ngarkese	15 – 25 %
- qendrueshmeria deri ne keputje	deri ne 70 %
- penetrimi i ujit gjendje statike	> 240 minuta
- rregjia	0 % rregjia shume e mire

- Astari per te gjitha pjeset e brendeshme te jete meshin dhije,me keto te dhena (sipas STASH 1144 – 89) :

- ngjyra	te jete e ngjyrosur
- trashesia	0.9 – 1.2 mm
- yndyra	4 -7 %
- rezistenca ndaj plasjes se faqes	> 1.3 kG/mm ²
- rezistenca ndaj keputjes se faqes	> 1.5 kG/mm ²
- zgjatimi ne ngarkese	15 – 30 %
- rregjia	0 % rregjia shume e mire

- Ngjitesa me 1 komponente dhe per ngjitjen e pjeses se poshteme (sholles me fjapen) me 2 komponente.
- Penj sintetik me ngjyre te zeze per qepje e lekures 100 % sineteik dhe qendrueshmeri mbi 9 kG,per masurin Nm 40/3 dhe gjilperen Nm 30/3
- Penj sintetik i thurur 1 mm per qepje 100 % PES dhe rezistence 38 kG (1000 g)
- Bombe termoplastike me trashesi 1.4 deri 1.7 mm.
- Forte soleti me trashesi 2.5-3.2mm.

Dokumentat Standarde të Tenderit

- Taban soleti me trashesi 3 deri 3.5 mm.
- Fjap gome me trashesi 4 deri 4.2 mm, e shoqeruar me xhiro gome me pjerresi konike dhe gjeresi te saj 17-19 mm. sipas STASH 2896-87
- Pjesa e poshtme te jete gome e presuar me fortesi 75 +/-3 grade shore (sipas STASH 2638-87), cilesia e pare. Goma e presuar poshte te jete e dhembzuar ose me lule ne pjesen me llokma trashesia te jete 13-14 mm ndersa pa llokma trashesia te jete 7-8 mm.
- Astar shtroje karton fiber me trashesi 1.4 – 1.7 mm.
- Kamarete e kurbezuar me gjeresi 17 –20 mm dhe gjatesi sa 1/3 e gjatesise se kepuces.
- Rezistenca ne shqitje e gomes: shume e mire sipas (STASH 1150/8-89).
- Percaktimi i qendrueshmerise se ngjyres: Ne te thate nuk lejohet çngjyrosja (STASH 1150/7-89).

9. Bluze dimerore

Material: 100% poliester

Pesha: 240 gr/m²

Thurja: trikotazh i krehur nga te dyja anet (jo pushezim)

Ngjyra: Blu navy

Mbyllja e bluzes behet me gjysem zinxhiri nga pjesa e gjoksit deri ne fundin e jakes.

Ne anen e majte te gjoksit vendoset velkrof dhe ne krahun e majte vendoset velkrof per stemen.

Ne pjese e shpines prapa do te jete mbishkrimi “zjarrfikes” me qendisje .

10. KOSTUM SHERBIMI (INTERVENIM I LEHTE FLAKDURUES)

Xhaketa: Materiali: 75% pambuk , 24% poliester dhe 1% flakeduruese(flame retardant)

CE EN 1149-2

Pesha: 240 gr/m²

Thurja: diagonal 2/1 antistatike

Ngjyra: blu navy

Xhaketa eshte e pajisur me xhepa perpara dhe dy xhepa siper me kapak.

Mbyllja e xhaketes behet me kopsa te fshehta.

Ne pjesen e brendshme eshte e perbere me mbushje me vatine me trashesi 0.5 cm dhe 100% poliester.

Xhaketa ka ne bustin e saj dy shirita fosforeshent te verdhe flakedurues, ku njera ne fund te gjoksit dhe nje ne pjesen fundore te xhaketes. Dhe nje shirit ne pjesen e menges.

Ne pjesen e shpines stampohet me shkrtim flakedurues fosforeshent “zjarrfikes”

E pajisur me velkrof ne anen e majte te gjoksit dhe ne anen e majte te krahut.

Xhaketa ka dy te cara anesore me thellesi 15 cm per nje rehati ne perdorim.

Pantallonat Materiali: 75% pambuk , 24% poliester dhe 1% flakeduruese(flame retardant)

CE EN 1149-2

Pesha: 240 gr/m²

Thurja: diagonal 2/1 antistatike

Ngjyra: blu navy

Pantallonat ne pjesen perpara eshte e mbyllur me nje zinxhir me sallki me qemer dhe i pajisur me ylyqe dhe dy xhepa anesore te pjerret me astar .

Dokumentat Standarde të Tenderit

Ne pjesen sipër gjurit, pra te kofshes, i pajisur me dy xhepa anesore ne forme zarfi me kapak.
Ne pjesen e kercirit i pajisur me shirit fosforeshent zjarrdurues.

Shtojca 12

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në Marrëveshjen Kuadër]

PLANIFIKIMI I KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR

--

Dokumentat Standarde të Tenderit

Mall: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		

Shtojca 13

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

(Kjo Shtojcë, ne rastin e Marrëveshjes Kuadër, do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Dokumentat Standarde të Tenderit

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006”Për Prokurimin Publik”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____
numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur

Dokumentat Standarde të Tenderit

fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

_____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

_____ *numri i NIPT-it*

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

_____ *numri i NIPT-it*

2. _____

Dokumentat Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____
Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____
Vlera _____ / Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

KUSHTET E PËRGJITHSHME Mallrat – Tender i Kufizuar

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për blerjen e mallrave të prokuruarra me anë të procedurës së kufizuar.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë shpërndarjen e funksioneve, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktor.
- 2.4 “Lëvrimi ” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikëqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas

Dokumentat Standarde të Tenderit

dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thotë materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë, të lëngshme ose të gazshme.
- 2.9 “Shërbimet në Lidhje me to” do të thotë shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Mallrat dhe Shërbimet në Lidhje me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkuara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë entitet tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nënkontraktuesin të kryejë punën e

Dokumentat Standarde të Tenderit

tij sipas kontaktës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nën-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikatat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake më shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Mallrave

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, ose prodhuar. Materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit që siguron materialet.

Neni 8: Qëllimi i Furnizimit dhe Përshtatshmeria e Mallrave me Specifikimet

- 8.1 Kontraktuesi duhet të dorezojë Mallrat me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 8.2 Mallrat nuk janë në përputhje me kontratën, nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin e posaçem të parashikuar në kontratë. Kur nuk është e mundur të përcaktohet një gjë e tillë, thuhet se Mallrat nuk janë në pajtim me kontratën nëse ato nuk janë të përshtatshme për përdorimin për të cilin shërbejnë zakonisht sendet e tjera të të njëjtit lloj.

Dokumentat Standarde të Tenderit

- 8.3 Në se shitja është bërë në bazë të një modeli ose kampioni, shitësi (Kontraktuesi) duhet të dorëzojë sendet që kanë të njëjtat cilësi si te modelit ose kampionit.

Neni 9: Pershtatshmeria e Mallrave me Standartet Teknike

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standarteve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet perkatese ose ne Standartet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktues.
- 9.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozite tjetër të kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë Standart Teknik perkates në specifikimet teknike, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike ndërkombëtare te tanishme. Nëse nuk ekzistojnë Standarte Teknike ndërkombëtare, Mallrat duhet të jenë konform Standarteve Teknike perkatese Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk do të jetë përgjegjës për gabime në skicim, të dhëna, vizatim ose çdo aspekt tjetër të specifikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktues me përjashtim të rastit kur gabimi ishte aq i dukshëm sa Kontraktuesi duhet ta kishte parë dhe këshilluar Autoritetin Kontraktor për të.
- 9.4 Shiteshi (Kontraktuesi) nuk mban përgjegjësi për defekte të pronës (Mallrave) për të cilat Autoriteti Kontraktor ishte në dijeni në momentin e lidhjes së kontratës ose nuk ishte në dijeni për faj të tij, me përjashtim të rastit kur defektet kanë të bëjnë me cilësinë e Mallrave të specifikuar sipas kontratës ose perfaqsimin e reklames së shitesit (Kontraktuesit).

Neni 10: Pjesët e Këmbimit

- 10.1 Në se kontrata parashikon, Kontraktuesi duhet të përfshijë me Mallrat e dhëna një sasi pjesësh këmbimi, në akordim me specifikimet teknike dhe çdo dispozitë perkatese të kontratës.
- 10.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe, pjesët e këmbimit do të dorëzohen bashkë me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet të garantojë disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit për një periudhë të specifikuar në ofertën e tij dhe të barabartë me jetgjatësinë e përdorimit të Mallrave.
- 10.4 Në rast të një vendimi të ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor në kohë të mjaftueshme për të lejuar Autoritetin Kontraktor të prokurojë sasi të mjaftueshme për përdorim të mëvonshëm.
- 10.5 Pas ndërprerjes së prodhimit të pjesëve të këmbimit, Kontraktuesi duhet t'i japi gratis Autoritetin Kontraktor në se ai kërkon, çdo prodhim, vegël, skicim të pjesëve të këmbimit të përdorura në prodhimin dhe mirmbajtjen e Mallrave.

Neni 11: Ambalazhimi

- 11.1 Kontraktuesi duhet të dorëzojë Mallrat të vendosura dhe të ambalazuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.
- 11.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë nen tjetër i kontratës, mund të thuhet se

Dokumentat Standarde të Tenderit

Mallrat nuk janë vendosur dhe paketuar në pajtim me kontratën në se ato nuk janë vendosur dhe paketuar në të njëjtën mënyrë që bëhet zakonisht për gjërat e të njëjtit lloj ose, në se mënyra e zakonshme nuk është e disponueshme, në një mënyrë që është e përshtatshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

Neni 12: Testimet dhe Inspektimet

- 12.1 Kontraktuesi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktuesi brenda kushteve të çmimit të kontratës
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet.
- 12.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktuesit të bëjë teste ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Mallrat janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Më tej, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do të bie dakort të ndryshojë grafikun e levrimit.
- 12.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Mall që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
- 12.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i Mallrave nuk do ta clirojë Kontraktuesin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 13: Kushtet e Dorëzimit

- 13.1 Kontraktuesi është i detyruar të kryejë të gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorëzimit me përjashtim kur Kontraktuesi përjashtohet në mënyrë specifike nga një aktivitet ose veprim i tillë nga ndonjë dispozitë e kontratës. Nëse një Incoterm përdoret për të përshkruar detyrimet e palëve, termi do të ketë kuptimin që i ka dhënë botimi i fundit i *Incotermave* botuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë.
- 13.2 Vendi i dorëzimit të Mallrave do të jetë sipas specifikimit të kontratës.
- 13.3 Koha e dorëzimit të Mallrave dhe data e përfundimit të Shërbimeve në Lidhje me to do të jetë sipas specifikimit në kontratë.
